



PËRSHËNDETJA E PARTISË SË PUNËS TË BELGJIKËS PARAQITUR NGA SHOKU VIM KENIS

Të dashur shokë,

Partia e Punës e Belgjikës falenderon ngrohtësisht Partinë Komuniste të Shqipërisë për ftesën që i dërgoi Partisë sonë për të marrë pjesë në 100 vjetorin e lindjes së Enver Hoxhës, themeluesit e udhëheqësit të shquar të PKSH-së.

Më lejoni që me këtë rast të flas për disa nga idetë e aksionet më të rëndësishme të shokut Enver Hoxha në periudhën e Luftës së Dytë Botërore, që janë sigurisht të lidhura ngusht me ato të PKSH dhe të cilat i frymëzojnë gjithnjë komunistët edhe sot.

1. Kalitja dhe ruajtja e unitetit të Partisë është një çështje esenciale, me rëndësi e dorës së parë. Në kushtet e luftës kundër pushtuesit fashist italian dhe për çlirimin kombëtar, komunistët shqiptarë u bashkuan dhe më 8 nëntori 1941 themeluan Partinë e tyre Komuniste. Sikurse ka shkruar Enver Hoxha kjo ishte e domosdoshme, "konditë sine qua non për organizimin e luftës për çlirim dhe sigurimin e udhëheqjes e saj".
2. Zhdërvjelltësia në taktikë e lidhur me militantizmin për të bërë për vete masat popullore, për të fituar besimin e tyre. PKSH kishte trashëguar nga grupet komuniste, prej të cilave kishte dalë, lidhje të dobëta me masat. Në të njëjtën kohë pushtuesit italianë kishin instaluar në Shqipëri forca të shumta dhe kudo mbrëtëronte një terror i egër. Në këto kondita detyra më e rëndësishme ishte lidhja me masat popullore, mobilizimi i popullit në luftë, bindja e tyre në drejtësinë e vijës politike të Partisë dhe hedhja në aksion për çlirimin kombëtar kundër pushtuesve fashistë. Se pa aksione nuk mund të ketë Parti Komuniste.
3. Taktika për të mbledhur në numër sa më të madh njërezish në Frontin Nacionalçlirimtar. Më 1941 komunistët shqiptarë përcaktuan vijën e tyre politike për Frontin Nacionalçlirimtar, "bashkimin e të gjithë njerëzve patriotë, që e duan Shqipërinë, në luftën kundër fashizmit". Ata, në të njëjtën kohë, përcaktuan si detyrë lidhjen e luftës nacionalçlirimtare me luftën e madhe antifashiste botërore, duke nënvizuar se "duhet në radhë të parë të lidhim ngushtë luftën tonë nacionalçlirimtare me luftën heroike të Bashkimit Sovjetik, që është pararoja e luftës kundër fashizmit".

Në shtator 1942, PKSH ndërtoi zyrtarisht Frontin Nacionalçlirimtar nën udhëheqjen e saj. Që në fillim të vitit 1943, Enver Hoxha shkruante se "ne nuk mundet ta bëjmë luftën vetëm, po bashkë me gjithë popullin" dhe prandaj i konsideronte lidhjet me nacionalistët një detyrë shumë serioze.

4. Rindërtimi i Shqipërisë. Që më 28 nëntor 1944, kur hyri me Qeverinë Demokratike në Tiranë, Enver Hoxha mbajti një fjalim të rëndësishëm dhe hodhi parullën e luftës për rindërtimin e Shqipërisë, për ndërtimin e ekonomisë



së saj, për zhvillimin e kulturës dhe arsimin e popullit dhe për ngritjen e nivelit të tij social, ekonomik e politik. Për 40 vjet rresht, Enver Hoxha udhëhoqi transformimin e vendit dhe e shndërroi Shqipërinë në një vend socialist me një bujqësi e industri të zhvilluar, me një klasë punëtore të përparuar, elektrifikimi shkoi në çdo fshat, shërbimi arsimor e shëndetësor u bënë falas, populli s'kishte taksa e tatime, gratë fituan të drejta njësoi si burra.

5. Të bashkojmë luftën parimore me luftën për forcimin e unitetit të lëvizjes komuniste. Që nga vitet 1950, divergjencat politike e ideologjike çuan në një luftë të ashpër në gjirin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Enver Hoxha iu kundërvu, bashkë me komunistët e tjetër, përpjekjeve për revisionizmin e marksizmit e leninizmit nga Hrushovi në lidhje me shtetin, revolucionin socialist dhe ndërtimin e shoqërisë socialiste. Më vonë kundërrevolucioni fitoi në Bashkimin Sovjetik e në vendet socialiste të Evropës. Kapitalizmi paraqitej në botë si sistem i vetëm i mundshëm, imperializmi paraqitej si i pathyeshëm. Lëvizja komuniste ishte në përshtjellim. Ne mendojmë, si të tjerët, që ka ardhur koha për të punuar së bashku për rivendosjen e unitetit të lëvizjes komuniste, po kjo është e mundur veçse përmes një analize kritike e autokritike të së shkuarës nga secila parti komuniste.

Të dashur shokë,

Partia e Punës e Belgjikës është e mendimit se lufta e klasave në nivel kombëtar e ndërkombëtar nuk mund të ndalet dhe se ne nuk duhet vetëm të flasim sëbashku, por edhe të veprojmë sëbashku në praktikë. Dihet se kriza e sistemit kapitalist botëror godet ashpër masat popullore. Dihet gjithashtu se borgjezia përdor me vendosmëri antikomunizmin e reformizmin në përpjekjet për të penguar rrugën, që është dalja e vetme nga kriza, socializmin. Janë uniteti dhe aksionet e përbashëta të partive komuniste ata që do të mund të rrisën influencën e tyre në masat, të cilat në gjithë botën kërkojnë pa pushim një alternativë të vërtetë socialiste.

Komunizmi është e ardhmja e njerëzimit!

Nderim për shokun Enver Hoxha!